



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 15.10.2012
Nr. 02041086

Për: Nexhmidin Arifi, Kryetar i Komunës Viti
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit Komunal Viti

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS
VITI, NR. 01-013/1196, të pranuar me datë, 08/10/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit nr. 01-013/1196 i datës 05.10.2012 të Kuvendit të Komunës së Vitisë për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale OVL të UÇK-së, Autoparkingjet në Komunën e Vitisë, **KONSTATON** se:

- Vendimi nr. 01-013/1196, Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, OVL të UÇK-së, Autoparkingjeve në Komunën e Vitisë të datës 08.10.2012, i Kuvendit të Komunës së Vitisë është në kundërshtim me nenin 5 dhe 7 të Ligjit nr. 03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 4, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale **kërkon** nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Vitisë që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimi 01-013/1196, i Kuvendit të Komunës së Vitisë është për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristiana, 15.10.2012
Br. 02041086

Za: Nexhmidin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitina

PREDMET: ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINA VITINA BR. 01-013/1196, primljeno dana, 08/10/2012

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstava, posle razmatranja zakonitosti Odluke br. 01-013/1196 od dt. 05.10.2012 Skupštine Opštine Vitina za davanje na korišćenje opštinske imovine ORV OVK, Autoparkinge u Opštini Vitina, **KONSTATUJE da je:**

- Odluka br. 01-013/1196, za davanje na korišćenje opštinske imovine, ORV OVK, Autoparkinge Opštini Vitina od dt. 08.10.2012, Skupštine Opštine Vitina je u suprotnosti sa članom 5 i 7 Zakona br. 03/L-226 za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine i člnu 4, 5 i 6 Administrativnog Uputstva Br.2012/02 za sprovođenje Zakona za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Vitina da preduzme konkretne mere da, Odluka 01-013/1196, Skupštine Opštine Vitina za davanje na korišćenje opštinske imovine, da se uskladi sa zakonskim dispozicijama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VITISË

05-10-2012



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

01-013/1196

Në bazë të nenit 12.2 pika 2, nenit 17 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 36 paragrafi 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 03.10.2012 miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË AUTO PARKINGJEVE NË QYTETIN E VITISË OVL TË UÇK-SË DEGA NË VITI

Neni 1

Objekt i këtij vendimi është dhënia në shfrytëzim i auto parkingjeve të shënuara në qytetin e Vitisë Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dega në Viti.

Neni 2

Qëllimi i këtij vendimi është që auto parkingjet e qytetit si resurse t'u jepen në dispozicion OVL të UÇK-së, për funksionimin e tyre dhe për asistencë më të mirë të familjeve të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës si dhe për institucionalizimin e raporteve në mes të OVL-së së UÇK-së dega në Viti dhe Komunës së Vitisë.

Neni 3

Obligimet e Komunës

Komuna e Vitisë merr për obligim që t'u jep në shfrytëzim auto parkingjet në qytet ashtu si është precizuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë 01. nr 013/1475 të datës 11.05.2011 dhe të krijoj kushte normale për punë në këto auto parkingje.

Obligimet e OVL-së së UÇK-së, dega në Viti

OVL e UÇK-së dega në Viti merr për obligim:

1. Kujdesi për pastërtinë e auto parkingjeve dhe hapësirave të gjelbëruara për rroth.
2. OVL e UÇK-së obligohet për punësimin e punëtorëve sipas nevojës dhe nuk mund të largohet nga puna deri sa para organeve komunale nuk sjellin argumente të qëndrueshme për shkelje të obligimeve të punës.
3. OVL e UÇK-së obligohet që të mirëmbaj shënimin horizontal të auto parkingjeve.
4. Nga të hyrat e grumbulluara e mjeteve 120 Euro në muaj do të derdhen në buxhetin e komunës.
5. Për parkingjet e rezervuara dhe me pagesë mujore OVL-ja duhet të bëjë marrëveshje me DSHP-në.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

- 1 Drejtorisë për Shërbime Publike
- 2 Shërbimit të Kuvendit
- 3 Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hecibi

